



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GJERGJ R. KONGOLI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. MIHAL DURI
TEL: 0682033057



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1782

Nr. koleksioni: 722

Tirane më 30/03/2023

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023053630073413286



A2023053630073413286

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 30/03/2023 (dymijë e njëzet e tre), para meje noterit publik, Gjegj Kongoli, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në Rrugën Mihal Duri, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse: Klodiana Stopani, atësia Fani, amësia Natasha, shtetase Shqiptare, lindur në Patos dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr.'Tom Plezha', Pa.Konfort Konstruksion; Nd. Ap.40; H. Shk.2; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, lindur më 04/08/1981, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034279172 dhe nr. personal I15804002K.

Dhënësi Pëlqimi: Vasillaq Stopani, atësia Gori, amësia Polikseni, shtetas Shqiptar, lindur në Sqepur, Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Rr."Tom Plezha', Pa.Konfort Konstruksion; Nd. Ap.40; H. Shk.2; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, lindur më 30/12/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 036573215 dhe nr. personal G91230001U

Pala Blerëse: Shoqëria "METRO FARMACI" SHPK, shoqëri tregtare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 03.02.2015, me NUIS (NIPT) L52403033A, me zyrë qendrore në Tirane, rruga "Myslym Shyri", pallati 10, kati përdhe, dyqani nr.1, e përfaqësuar administratori Z. Dorian Sadiku, atësia Tahir, amësia Elisabetë, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, me adresë Vasil Shanto; Nd. 170; H. 00; Ap. 000; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 20/06/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 028835695 dhe nr. personal H90620115D.

Kushtet Paraprake

- Shoqëria "DITË E NATË" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 17.02.2020, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) M01417001E; me zyrë qendrore në Tiranë, me kapital të regjistruar 100,000 (njëqind mijë) lekë; me dy ortakë, shoqërinë "Metro Farmaci" SHPK, zotëruese e I (një) kuote, e cila përbën 90% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe znj. Klodiana Stopani, zotërues i I (një) kuote, e cila përbën 10 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- Pala shitëse është e interesuar të shesë kuotën e cila përfaqëson 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:



A2023053630073413286

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse znj. Klodiana Stopani, i shet palës blerëse shoqëria "METRO FARMACI" SHPK, kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK dhe e cila përbën 10% të kapitalit të kësaj shoqërie.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate, ortak i vetëm i shoqërisë "DITË E NATË" SHPK, do të jetë shoqëria "METRO FARMACI" SHPK, e cila do të jetë zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës që znj. Klodiana Stopani zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, objekt i kësaj kontrate, është € 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë euro). Palët bien dakord që çmimi i shitjes do të paguhet brenda 10 ditësh, afat ky që fillon nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate.

3.2 Shuma e mësipërme do të likuidohet nga pala blerëse shoqëria "METRO FARMACI" SHPK, në llogarinë bankare ndërmjetëse OSS të Noterit Gjergj Kongoli pranë Bankës OTP Sh.A me nr.00001273634, për t'u transferuar më pas në llogarinë bankare të palës shitëse Klodiana Stopani, me të dhënat e mëposhtme:

- Banka Kombëtare Tregtare;
- Klienti: Klodiana Stopani;
- Numër llogarie: 521002693SAVAIDEURQZ;
- IBAN: AL5320511715002693SAVAIDEURQ

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

4.2 Palët kësaj kontrate detyrohen që asnjëra prej tyre të mos tërhiqet nga kjo kontratë. Në rast se ndonjëra prej palëve tërhiqet nga kontrata apo kryen ndonjë veprim me qëllim mosplotësimin e kushteve të përcaktuara në dispozitat e kësaj kontrate, atëherë pala që tërhiqet ose kryen veprimin, detyrohet t'i paguajë palës tjetër një penaltitet sipas ligjit.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, pavarësisht se çmimi i saj do të paguhet brenda 10 ditësh nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, do të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe shoqëria "METRO FARMACI" SHPK do të bëhet ortakë në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Në momentin e regjistrimit të kësaj kontrate sipas nenin 5.1, pronësia mbi kuotën e cila përbën 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK, do të kalojë nga pala shitëse Klodiana Stopani, tek pala blerëse shoqëria "METRO FARMACI" SHPK.

5.3 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e pjesën e kuotës e cila përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërinë "DITË E NATË" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse, shoqëria "METRO FARMACI" SHPK.

VI. DHËNËSI I PËLQIMIT

Dhënësi i pëlqimit z. Vasillaq Stopani, bashkëshorti i ortakes Klodiana Stopani dhe bashkëpronar në kuotën që znj. Klodiana Stopani zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, për efekt të martesës, deklaron se është dakord që kuota, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortes së tij, t'i shitet shoqërisë "METRO FARMACI" SHPK.

Fq 2



A2023053630073413286

Dhënësi i pëlqimit z.Vasillaq Stopani, deklaroi se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortes së tij për shitjen e kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këtë shitje dhe me sa është deklaruar e rënë dakord midis palëve në këtë kontratë.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE

KLODIANA STOPANI

Klodiana Stopani

PALA BLERËSE

**SHOQËRIA "METRO FARMACI" SHPK
përfaqësuar nga administratori
DORIAN SADIKU**

Dorian Sadiku

**DHËNËSI I PËLQIMIT
VASILLAQ STOPANI**

Vasillaq Stopani



**NOTER
GJERGJ KONGOLI**

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
"DELTA HOLDING" SHPK**

Sot, në datën 21.03.2023, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë "DELTA HOLDING" SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS (NIPT) M31316015P, me zyrë qendrore në adresën Autostrada Tiranë – Durrës, km. 3, zona kadastrale 2679, nr. pasurie 19/27/1, Mezëz, Kashar, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, mbledhje e thirrur nga administratorit i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë dhe nenin 83 paragrafi i fundit të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë prezent ortakët e shoqërisë të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- z. Dorian Sadiku, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- z. Eduard Curraj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Mbledhja mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

- blerjen nga shoqëria "METRO FARMACI" SHPK të kuotës të zotëruar nga ortakja Klodiana Stopani në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, kuotë e cila përbën 10% të kapitalit të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK;
- përcaktimin e çmimit të blerjes, pagimin e këtij çmimi, kalimin e kuotës;
- të ndryshme.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, Asambleja e Përgjithshme me unanimitet:

V E N D O S I

- 1) Blerjen nga shoqëria "METRO FARMACI" SHPK të kuotës të zotëruar nga ortakja Klodiana Stopani në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, e cila përbën 10% të kapitalit të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK.
- 2) Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë në vlerën € 150,000 (njëqind pesëdhjetë mijë euro). Çmimi do të paguhet brenda një afati 10 ditor nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- 3) Kontrata e shitblerjes së kuotës do të hartohet dhe nënshkruhet nga administratori i shoqërisë "METRO FARMACI" SHPK.
- 4) Ngarkohet administratori i shoqërisë "DELTA HOLDING" SHPK, për respektimin e këtij vendimi dhe depozitimin e tij në dokumentacionin e shoqërisë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (ORTAKËT)

DORIAN SADIKU

Dorian Sadiku




EDUARD CURRAJ

Eduard Curraj


"METRO FARMACI" SHPK
NUIS L52403033A

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME (ORTAKUT TË VETËM)
TË SHOQËRISË "METRO FARMACI" SHPK

Sot, në datën 21.03.2023, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë "METRO FARMACI" SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS (NIPT) L52403033A, me zyrë qendrore në lagjia "Komuna e Parisit", rruga "Dervish Bej Mitrovica", pallati "Kristi Co", nr. 6, dyqani nr. 1, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) të shoqërisë, mbledhje e thirrur nga administratorit i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë dhe nenin 83 paragrafi i fundit të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme është prezent ortaku i vetëm i shoqërisë shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK, zotëruese e 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë, e përfaqësuar nga

Mbledhja mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

- Blerjen nga ortaku shoqëria "METRO FARMACI" SHPK të kuotës të zotëruar nga ortakja Klodiana Stopani në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, kuotë e cila përfaqëson 10% të kapitalit të regjistruar të kësaj shoqërie.
- përcaktimin e çmimit të blerjes, pagimin e këtij çmimi, kalimin e kuotës,
- të ndryshme.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm):

V E N D O S I

- 1) Blerjen nga ortaku shoqëria "METRO FARMACI" SHPK të kuotës të zotëruar nga ortakja Klodiana Stopani në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, e cila përbën 10% të kapitalit të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK.
- 2) Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë në vlerën € 150,000 (njëqind pesëdhjetë mijë euro). Çmimi do të paguhet brenda një afati 10 ditor nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- 3) Ngarkohet administratori i shoqërisë "METRO FARMACI" SHPK, z. Dorian Sadiku që në respektim të zbatimit të këtij vendimit, të kryejë vetë personalisht ose nga persona të tjerë të autorizuar prej tij, të gjithë veprimet e nevojshme administrative për regjistrimin e këtij vendimi dhe dokumentacionit tjetër përkatës pranë institucioneve kompetente shtetërore.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (ORTAKU I VETËM)

"DELTA HOLDING" SHPK

DORIAN SADIKU

Dorian Sadiku
[Signature]



EDUARD CURRAJ

Eduard Curraj
[Signature]